



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.12/24
Datë: 01.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 01.02.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aksioneve dhe marrjen e kontrollit të përbashkët nga ALFI Renewables d.o.o., dhe MK Green Energy LTD mbi Suntastic One d.o.o., edhe në Suntastic Two d.o.o.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 14.11.2023, me Nr. Prot. 540/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aksioneve dhe marrjen kontrollit të përbashkët nga ALFI Renewables d.o.o., dhe MK Green Energy LTD ku secili do të zotëroj nga 50% të aksioneve si në Suntastic One d.o.o., ashtu edhe në Suntastic Two d.o.o.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 04.11.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 05.01.2024
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshje/Letër Qëllimi jo-detyruese më 13 Nëntor 2023, përmes së cilës ata shprehin qëllimin e tyre serioz për të hyrë, në kohën e duhur, në një marrëveshje ligjërish të detyrueshme.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja/Letër Qëllimi jo-detyruese më 13 Nëntor 2023, përmes së cilës ata shprehin qëllimin e tyre serioz për të hyrë, në kohën e duhur, në një marrëveshje ligjërish të detyrueshme.
4. Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesi është ndërmarrje e ndërlidhur me kompaninë e cila realizon të hyra përmes shitjeve në Republikën e Kosovës.

ALFI Renewables, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o., kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me adresë të regjistruar në Rrugën Verovškova u55A, 1000 Ljubljana, Republika e Sllovenisë, e regjistruar pranë Regjistrimit Gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Ljubljana, me numër të identifikimit 8775958000 (blerësi 1). **ALFI Renewables** është një kompani sllovene e angazhuar në menaxhimin e fondeve të investimeve alternative, e inkuorporuar në fund të vitit 2020, me aktivitetin kryesor të regjistruar afarist - menaxhimin e fondeve. ALFI Renewables dhe ALFI Green Energy Fund janë pjesë e Alfi Group (“**Alfi Group**”) dhe konsiderohen si kompani të ndërlidhura, nën kontrollin dhe pronësinë e të njëjtit aksionar. Përmes kompanive të lidhura me portofolin e tij, Alfi Group është prezent dhe gjeneron qarkullim në Kosovë.

MK Green Energy LTD, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Qipros, me adresë të regjistruar në Griva Digeni 115, Trident Centre, 3101 Limasol, Republika e Qipros, me numër të regjistrimit HE 410180 (blerësi 2). Parashtruesit e kërkesës do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi ndërmarrjet si më poshtë:

Suntastic One d.o.o. Beograd, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, me adresë të regjistruar në Vladimira Popovića 50, Kati i 6, Apartamenti no. 463, 11070 Beograd (Beograd i ri), regjistruar pranë Agjencionit Serb të Regjistrimit të Biznesit me numër regjistrimit 21715883 (targeti 1). **Suntastic One** është themeluar në shtator 2021 me qëllim të zhvillimit të impiantit diellor “*Suntastic One solar PV*” në komunën e Aleksinac, Republika e Serbisë, me kapacitet maksimal kyçje prej 8.75 MWe. Suntastic One aktualisht është në pronësi të personave fizikë znj. Ivana Yaman, e cila zotëron 78%, z. Zoran Paunović, i cili zotëron 12%, dhe znj. Jovana Nikolić, e cila zotëron 10% të kapitalit aksionar të Suntastic One.

Suntastic Two d.o.o. Beograd, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, me adresë të regjistruar në Vladimira Popovića 50, Kati i 6, Apartamenti no. 463, 11070 Beograd (Beograd i ri), regjistruar pranë Agjencionit Serb të Regjistrimit të Biznesit me numër regjistrimit 21715905 (targeti 2) **Suntastic Two** është themeluar në shtator 2021 me qëllim të zhvillimit të impiantit diellor “*Suntastic Two solar PV*” në komunën e Aleksinac, Republika e Serbisë, me kapacitet maksimal kyçje prej 8.75 MWe. Suntastic Two aktualisht është në pronësi të personave fizikë znj. Ivana Yaman, e cila zotëron 78%, z. Zoran Paunović, i cili zotëron 12%, dhe znj. Jovana Nikolić, e cila zotëron 10% të kapitalit aksionar të Suntastic Two (individët e njejtë që janë aksionarë tek Suntastic One

Tregu Relevant:

Tregu i produktit: tregu për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike.

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar do të jetë tregu ndërkombëtar.

Analiza e konkurrencës

Tregu i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, dhe investimi në këtë industri do të jetë i një rëndësie të madhe për prodhimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (energji solare). Prandaj, projektet e energjisë diellore do të gjenerojë vlerë të shtuar të fortë për sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Tregu për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike, edhe sipas Komisioni Evropian zakonisht nuk bën dallim midis burimeve të ndryshme të energjisë të përdorura dhe konsideron se tregu përkatës përfshin të gjitha objektet e prodhimit të energjisë elektrike, pavarësisht nëse kjo energji elektrike është të marra nga gaz, burimet e rinovueshme etj.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra palë në transaksionin realizon të hyra përmes kompanive të ndërlidhura është prezentë në Republikën e Kosovës. Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën. Duke pasur parasysh që, asnjë palë nuk është e pranishme në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, ndërsa njëri nga parashtruesit e kërkesës realizon të hyra në Kosovë përmes kompanive të ndërlidhura e që është e papërfillshëm në tregun. Kompanitë e synuara nuk janë fare aktive në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe nuk do të ketë asnjë efekt negativ në tregun kosovar. Bazuar në sa më sipër, rezulton se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva